



REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Pranimar / Doretuar Prilapje / Prifato Received / Delivery	06.12.2023	3 viti god year	
Organ / Njësia Organ / Jedinstva Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPM/SHK/	7342/2023		114



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1378/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës- Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë, me Rushit Kajtazi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit në procedurën sipas ankesës A.nr.1378/2023 të datës 03.11.2023 të parashtruar nga ankuesi

kundër organit të punësimit Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, në çështjen juridike "Masë disiplinore", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 06.12.2023, mori këtë:

V E N D I M

I.REFUZOHET si e pabazuar ankesa A.nr.1378/2023 e datës 03.11.2023, e parashtruar nga ankuesja

II.MBETET në fuqi Vendimi me numër reference 383,përkatësishtë nr.prot.4781 i datës 20.10.2023, i Komisionit Disiplinor të Ministrisë se Punëve të Jashtme dhe Diasporës.

A r s y e t i m

Ankuesja me datë 03.11.2023, me numër protokoli 6867/2023, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore, kundër vendimit me numër protokoli 4781 të datës 20.10.2023 të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës(nw tekstin nw vijim MPJD-ja), lidhur me shqiptimin e masës disiplinore „Ndalim 20%, të pagës për periudhën tre (3) muaj”.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullos Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 07.11.2023, për mes emalit zyrtar

ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankueses tek MPJD-ja. Ndërsa Këshilli me datë 15.11.2023, ka pranuar nga MPJD-ja, përgjigjen në kërkesë me numër protokoli: 1378/2023, se bashku me shkresat e bashkangjitura.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave me rastin e shqyrtimit të kësaj ankese ka administruar këto prova: Ankesën A.nr.1378/2023 të datës 03.11.2023 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me numër reference 383, përkatësisht nr.prot.4781 të datës 20.10.2023, i Komisionit Disiplinor; Inicimi i procedurës disiplinore i datës 22.09.2023; kërkesa për pushim vjetor 03.07.2023; E-maili i datës 05.04.2023; E-maili i datës 23.01.2023; E-maili i datës 14.07.2023; E-maili i datës 24.10.2023; dy E-mailat e datës 09.10.2023; Procesverbali i seancës dëgjimore të komisionit disiplinor i datës 22.09.2023; Vendimi për pushim nga data 22.05.2023 deri më 02.06.2023; E-maili i datës 23.10.2023; E-maili i datës 20.10.2023; E-maili i datës 31.10.2023; E-maili i datës 20.10.2023; kërkesa për përgjigje në ankesë e datës 07.11.2023; Përgjigje në ankesë me numër protokoli 1378/2023, e datës 15.11.2023; E-maili i datës 22.10.2023; Vërejtje e datës 22.09.2023; lista e vijimit, deri me datën 31.07.2023; Emaili/ftesa për seancë dëgjimore në komision disiplinor e datës 06.10.2023 për ankuesen; Emaili/ftesa për seancë dëgjimore në komision disiplinor e datës 27.09.2023 për Inicuesin e procedurës disiplinore.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin në vijim Kolegji i Këshillit, pasi që ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa e ankueses është e pabazuar, sepse:

Kolegji i këshillit me rastin e shqyrtimit të kësaj ankese dhe vendimmarrjes në lidhje me të u bazua në Ligjin nr.08/L-197 për Zyrтарët Publik përkatësisht nenin 99 paragrafi 6, ku specifikisht thuhet: "6. Procedurat e rekrutimit, të disiplinës apo të ankesave të filluara dhe të papërfunduara në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, do të vazhdojnë sipas dispozitave të mëparshme ligjore, që kanë rregulluar çështjet përkatëse", ndërsa sa i përket shkeljeve të dispozitave ligjore duke marrë parasysh faktin se inicimi i procedurës disiplinore nga mbikëqyrësi i ankueses ka ndodhë me datë 22.09.2023, kur ka qenë në fuqi Ligji Nr.06/L-114 Për Zyrтарët Publik, janë marrë parasysh dispozitat e këtij ligji dhe akteve nënligjore që ndërlidhen me këtë çështje që është objekt i kësaj ankese.

Kolegji i këshillit bazuar në shkresat e lëndës përkatësisht sipas vendimit të komisionit disiplinor që është objekt i këtij kontesti konstaton se ankuesja mbanë pozitën Drejtor i Departamentit për Diplomaci Ekonomike në MPJD.

Komisioni Disiplinor i MPJD-së me Vendimin me numër reference 383, përkatësisht nr.prot.4781 të datës 20.10.2023, ankueses i ka shqiptuar masën disiplinore „ndalim 20%, të pagës për periudhën prej tre (3) muaj“. Kolegji i këshillit pasi që i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankueses bazuar në provat që janë dërguar nga palët në këtë procedurë, ka konstatuar se pretendimet ankimore të ankueses, nuk janë të bazuara, sepse ankuesja me veprimet e sajë, lidhur mungesën në punë nga data 17.07.2023, deri me datën 31.07.2023, pa miratimin e Udhëheqësit të Drejtpërdrejtë, ka bërë shkelje të detyrave të punës të aplikuara të përcaktuar sipas ligjit të aplikuar në këtë periudhë Nr.06/L-114 Për Zyrтарët Publik, dhe njëkohësisht ka konstatuar se lidhur me shqiptimin e masës disiplinore nga Komisioni Disiplinor i MPJD-së, përmes vendimit me numër reference 383, përkatësisht nr.prot.4781 të

datës 20.10.2023, me të cilin vendim ankueses ,i ka shqiptuar masën disiplinore "ndalim 20%, të pagës për periudhë tre (3) muaj", ka vepruar në pajtim me nenin 47, paragrafi 1, nen paragrafi 1.2, të Ligjit të aplikuar Nr.06/L-114 Për Zyrtarët Publik, ku thuhet se: "1. Masat disiplinore, të cilat mund të zbatohen ndaj nëpunësit civil, janë: 1.2. ndalimi nga 20% deri në 40% e pagës për një periudhë deri në gjashtë muaj", si dhe në pajtim me nenin 11, paragrafi 1, nen paragrafi 1.1,dhe 1.2 të Rregullores (QRK) nr. 11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë, ku thuhet se; 1. Komisioni disiplinor ka këto kompetenca: 1.1. Bënë shqyrtimin e fakteve dhe provave të paraqitura; 1.2. Përcakton dhe shqipton masën disiplinore", sepse në rastin konkret ankuesja, nga data 17.07.2023, deri më datë 31.07.2023, ka shkuar në pushim vjetor pa miratimin e Udhëheqësit të Drejtpërdrejtë, duke vepruar në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi.

Ndërlidhur me pretendimet ankimore të ankueses, lidhur me shqiptimin e masës disiplinore, Kolegji i këshillit ka konstatuar se masa disiplinore është shqiptuar në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi të aplikuara në këtë periudhë përkatësisht nenin 46, paragrafi 1, nën paragrafi 3.1 të Ligjit të aplikuar Nr.06/L-114 Për Zyrtarët Publik, nga se si rezultat i mungesës në punë ka rezultuar edhe me mos përmbushjen e detyrave të punës ashtu si parashihet me përshkrimin e vendit të punës të ankueses.

Kolegji i këshillit ndërlidhur me bazën ligjore të potencuar si më lartë ka konstatuar se ankuesja , me veprimet e saja, për mungesën në punë nga data 17.07.2023, deri me datën 31.07.2023, pa miratimin e Udhëheqësit të Drejtpërdrejtë, ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e Rregullores (QRK) Nr.07/2022 për Orarin e Punës dhe Pushimet e Zyrtarëve Publik respektivisht me nenin 11, paragrafi 1,2 dhe 3,ku përcaktohet se: "1.Për intervalin kohor të shfrytëzimit të pushimit vjetor, zyrtari publik duhet ta njoftojë mbikëqyrësin e drejtpërdrejtë më së paku pesëmbëdhjetë (15) ditë para fillimit të shfrytëzimit të pushimit vjetor,2. Me rastin e lejimit të pushimit vjetor, zyrtarit publik i lëshohet vendim për orarin dhe kohëzgjatjen e pushimit vjetor më së paku pesë (5) ditë para fillimit të shfrytëzimit të pushimit vjetor,3.Kërkesa për pushim vjetor miratohet nga Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë dhe njoftohet Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore. miratim apo refuzim të pushimit vjetor, evidentohet në dosjen individuale të zyrtarit publik", ndërlidhur me këto dispozita të potencuara si më lartë dhe bazuar në shkresat e lëndës konfirmohet fakti se me rastin e shkuarjes në pushim vjetor të ankueses nuk janë plotësuar asnjë nga dispozitat e lartshënuara nga se kërkesa për pushim ishte e datës 03.07.2023 me qëllim të shfrytëzimit të pushimit nga data 17.07.2023,që konfirmohet fakti se koha e parashtrimit të kërkesës dhe shfrytëzimit të pushimit nuk kanë mbështetje në paragrafin 1 të nenit 11 të rregullores së potencuar si më lartë për orarin e punës, dhe poashtu me rastin e shkuarjes në pushim vjetor të ankueses e njëjta nuk kishte vendim nga organi kompetentë ashtu si parashihet në paragrafin 2 të nenit 11 të së njëjtës rregullore mbi orarin e punës dhe poashtu kërkesa nuk ishte e miratuar nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë ashtu si parashihet në paragrafin 3 të nenit 11 të së njëjtës rregullore të apostrofuar si më lartë, andaj Kolegji i këshillit për faktin se nga shkresat e lëndës të dorëzuara nga palët nuk ka mundur të arsyetohet me asnjë provë se veprimet e ankueses kanë qenë në harmoni me këtë rregullore që e specifikua më lartë sa i përket shfrytëzimit të pushimit vjetorë, andaj edhe vendimi i Komisionit Disiplinor të MPJD-së, me numër reference 383,përkatësisht nr.prot.4781 të datës 20.10.2023 ,është i bazuar dhe në harmoni me Ligjin aktual nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, Ligjin e aplikuar në këtë periudhë të shkeljes së konstatuar Nr.06/L-114 Për Zyrtarët Publik përkatësisht nenin 46 paragrafi 1,paragrafin 2 nënparagrafin 2.1, paragrafin 3 nënparagrafin 3.5 dhe 3.10 dhe nenin 48 paragrafin 2 të këtij ligji, si dhe poashtu nenin 4,5 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 dhe paragrafin 2 dhe nenin 7 të

Rregullores (QRK) nr. 11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë, Rregulloren (QRK) Nr.07/2022 për Orarin e Punës dhe Pushimet e Zyrtarëve Publikë respektivisht nenin 11, paragrafi 1,2 dhe 3 dhe nenin 9 paragrafi 3,si dhe Ligjin Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Andaj nga ajo që u tha si më lartë në Vlerësimin e Kolegjit të këshillit, duke marrë për bazë edhe shkresat/ emailat e datës 23.01.2023 dhe 05.04.2023,me që rast të gjithë nëpunësit e MPJD-së kanë qenë të njoftuar në lidhje me çështjen se pa pasur aprovimin e mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë askush nuk mund të shfrytëzoj pushimin e kërkuar, fakt i konfirmuar edhe nga procesverbali i dëgjimit në seancën dëgjimore të komisionit disiplinor nga vetë ankuesja, andaj Komisioni Disiplinor i MPJD-së, me rastin e nxjerrjes së vendimit me numër reference 383,përkatësishtë nr.prot.4781 të datës 20.10.2023 ,me të cilin vendim ankueses i ka shqiptuar masën disiplinore "ndalim 20%, të pagës për periudhën tre (3) muaj", duke konstatuar drejtë gjendjen faktike dhe aplikuar drejtë bazën juridike, ka vepruar në pajtim me dispozitat e legjislacionit të potencuar si më lartë dhe mbi këtë bazë i ka lënë në fuqi masën e shqiptuar nga komisioni disiplinor i MPJD-së, ndërsa pretendimet tjera nuk ishin me relevancë dhe nuk kishin ndonjë ndikim për vendosje tjetër nga si është vendosë si në dispozitiv të këtij vendimi, poashtu nuk mori për bazë edhe vërejtjen e shqiptuar më datë 22.09.2023 të dorëzuar nga organi i punësimit nga se e njëjta është në proces të vendimmarrjes në këshill nga se ndaj të njëjtës ka ankesë dhe ende nuk ka fuqi ligjore.

Kolegji për shqyrtimin e ankesës, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar ne nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenin 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 Për procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda,A.nr.1378/2023,datë 06/12/2023

Rushit KAJTAZI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankueses
- Sekretarit të Përgjithshme në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së